



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 40 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, nenin 3, paragrafi 2 dhe 6, të Rregullores zgjedhore nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarinimin financiar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 21.08.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### Për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton kufirin e sipërm të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09 shkurt 2025, në shumën prej 2,047,149 euro
- II. Neni 2, i Rregullores zgjedhore nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarinimin financiar, parasheh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës do të jetë jo më pak se 1 euro për votues.
- III. Numri i votuesve sipas listës preliminare të regjistrit civil në Republikën e Kosovës është 2,047,149 votues të regjistruar.
- IV. Shpenzimet maksimale për fushatë nga pika 1 e këtij vendimi zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës që do të zgjas nga data 11 janar 2025 deri me 09 shkurt 2025, pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.
- V. Obligohet Zyra t'i njoftojë partitë politike të regjistruara për marrjen e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniq

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Prishtina



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe neni 127 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 21.08.2024, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### Për Miratimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme

- I. Miratohet Rregullorja Zgjedhore Nr. 15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme.
- II. Rregullorja si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjqi





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**  
**Centralna Izborna Komisija**  
**Central Election Commission**



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1. dhe 2.2, neni 5 paragrafi 5 dhe 6, neni 127 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 4, paragrafi 4.4, neni 11, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 21.08.2024, miraton këtë:

**RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 15/2024**  
**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME DHE TË JASHTËZAKONSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton afatet kohore për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore, pas publikimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, kuvendin komunal dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune.

**Neni 2**  
**Përcaktimi i afateve kohore**

1. Zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme rregullohen me ligje dhe Rregulloret e KQZ sikurse edhe zgjedhjet e rregullta, përveç përcaktimit të afateve kohore proporcionale për veprimet e përcaktuara në këtë nen, varësisht nga afati i përcaktuar për zgjedhjet respektive.
2. Një ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve të parakohshme dhe/apo të jashtëzakonshme, KQZ nxjerr vendim për caktimin e afateve kohore dhe planin e aktiviteteve të zgjedhjeve për:
  - 2.1. Pranimin e ekstraktit të parë të Regjistrimit Civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC);
  - 2.2. përcaktimin e kufizimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore;



- 2.3. emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ);
- 2.4. planin e rekrutimit të stafit zgjedhor;
- 2.5. planin e informimit publik;
- 2.6. planin e trajnimit;
- 2.7. funksionalizimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR);
- 2.8. publikimin e Qendrave të Votimit (QV);
- 2.9. themelimin funksionalizimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN);
- 2.10. periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve;
- 2.11. periudhën e aplikimit dhe regjistrimit për votim jashtë Kosovës;
- 2.12. deklarin e partive politike të regjistruara për mos pjesëmarrjen në zgjedhje;
- 2.13. deklarin e koalicioneve të partive politike për zgjedhje;
- 2.14. certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve;
- 2.15. korrigjimin e listave dhe zëvendësimin e kandidatëve;
- 2.16. periudhën e votimit jashtë Kosovës;
- 2.17. tërheqjen e shortit për renditje në fletëvotim;
- 2.18. fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimet e fushatës zgjedhore;
- 2.19. regjistrimin dhe Votimin e Personave me Nevoja të Veçanta (VNPV);
- 2.20. emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV);
- 2.21. emërimin e ekipeve të numërimit në QKN;
- 2.22. emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në përfaqësitë diplomatike;

- 2.23. periudhën e aplikimit dhe akreditimit të vëzhguesëve;
- 2.24. publikimin e raporteve financiare të fushatës;
- 2.25. certifikimin e Listës përfundimtare të votuesve;
- 2.26. afatet e aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj dhe rregulloret zgjedhore.

**Neni 3**  
**Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja Nr. 15/2023 për Zgjedhjet e Parakohshme, e datës 09.03.2023.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

\_\_\_\_\_  
**Kreshnik Radoniqi**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 5 paragrafi 7, nenin 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 21.08.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për miratimin e Planit të aktiviteteve për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- I. Miratohet Plani i aktiviteteve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Plani si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjqi



ID	Tasli Mod	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
1		<b>AFATET DHE PLANI I AKTIVITETEVE PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>	<b>179 days</b>	<b>Fri 16/08/24</b>	<b>Mon 10/02/25</b>
2		<b>AKTIVITETE TË VEÇANTA</b>	<b>9 days</b>	<b>Fri 16/08/24</b>	<b>Sat 24/08/24</b>
3		KQZ miraton afatet dhe planin e aktiviteve të zgjedhjeve	5 days	Fri 16/08/24	Tue 20/08/24
4		Publikimi i informatave për legjislacionin në fuqi që zbatohet për organizimin e zgjedhjeve dhe njoftimi për afatet zgjedhore	2 days	Tue 20/08/24	Wed 21/08/24
5		KQZ miraton projektbuxhetin për organizimin e zgjedhjeve	9 days	Fri 16/08/24	Sat 24/08/24
6		<b>PERIUDHA PËR CERTIFIKIMIN E SUBJEKTEVE POLITKE DHE KANDIDATËVE PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE DHE FUSHATA ZGJEDHORE</b>	<b>178 days</b>	<b>Fri 16/08/24</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
7		<b>Aktivite të veçanta</b>	<b>15 days</b>	<b>Fri 16/08/24</b>	<b>Fri 30/08/24</b>
8		KQZ merr vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve	2 days	Tue 20/08/24	Wed 21/08/24
9		Deklarimi i partive politike për formim të koalicioneve zgjedhore	15 days	Fri 16/08/24	Fri 30/08/24
10		Deklarimi i partive politike të regjistruara për mospjesëmarrje në zgjedhje	15 days	Fri 16/08/24	Fri 30/08/24
11		<b>Aplikimi dhe certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje</b>	<b>128 days</b>	<b>Sun 01/09/24</b>	<b>Mon 06/01/25</b>
12		Aplikimi për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve	102 days	Sun 01/09/24	Wed 11/12/24
13		Dorëzimi i kërkesave në institucione për verifikim të përshtatshmërisë së kandidatëve	94 days	Tue 10/09/24	Thu 12/12/24
14		Pranimi i përgjigjeve nga institucionet lidhur me verifikimin e kandidatëve	98 days	Tue 10/09/24	Mon 16/12/24
15		Zyra shqyrton shkresat e pranuar nga institucionet, sipas nenit 30 të LZP dhe kërkon nga subjektet politike zëvendësimin e kandidatit	98 days	Tue 10/09/24	Mon 16/12/24
16		Afati për paraqitjen e përmirësimeve, korrigjimeve nga Subjektet Politike	102 days	Tue 10/09/24	Fri 20/12/24
17		Zyra i shqyrton përmirësimet, korrigjimet dhe përgatit rekomandim me shkrim për KQZ-në për certifikim	104 days	Tue 10/09/24	Sun 22/12/24
18		KQZ merr vendim për aprovimin apo refuzimin e certifikimit të Subjekteve Politike dhe kandidatëve të tyre	104 days	Fri 13/09/24	Wed 25/12/24
19		Zyra njofton subjektet politike për vendimin e KQZ	104 days	Fri 13/09/24	Wed 25/12/24
20		Periudha për paraqitjen e ankesave në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)	105 days	Fri 13/09/24	Thu 26/12/24
21		Vendimmarrja e PZAP për ankesat e parashtruara kundër vendimit të KQZ	105 days	Sun 15/09/24	Sat 28/12/24
22		Paraqitja e ankesave në Gjykatën Supreme, kundër vendimit të PZAP, brenda 48 orëve	102 days	Fri 20/09/24	Mon 30/12/24
23		Marra e vendimeve nga Gjykata Supreme	103 days	Wed 25/09/24	Sun 05/01/25
24		Afati i fundit për tërheqjen e Subjekteve Politike dhe kandidatëve nga pjesëmarrja në zgjedhje	2 days	Sun 05/01/25	Mon 06/01/25
25		<b>Tërheqja e shortit dhe fushata zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët</b>	<b>35 days</b>	<b>Mon 06/01/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>



ID	Tas/ Mod	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
26	★	Përgatitjet teknike të Zyrës për tëreqjen e shortit për renditjen e Subjekteve Politike në fletëvotim	1 day	Mon 06/01/25	Mon 06/01/25
27	★	Tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletvotim	1 day	Tue 07/01/25	Tue 07/01/25
28	★	Periudha e fushatës zgjedhore për Subjektet Politike dhe Kandidatët e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje	30 days	Sat 11/01/25	Sun 09/02/25
29	★	Zyra i dërgon Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) të dhënat për subjektet politike të certifikuar dhe kandidatëve të tyre	1 day	Fri 10/01/25	Fri 10/01/25
30	→	<b>PERIUDHA E APLIKIMIT PËR AKREDITIM TË VËZHGUESVE</b>	<b>48 days</b>	<b>Wed 25/12/24</b>	<b>Mon 10/02/25</b>
31	→	<b>Aplikimi për akreditim të vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuar</b>	<b>42 days</b>	<b>Wed 25/12/24</b>	<b>Tue 04/02/25</b>
32	★	KQZ merr vendim për aprovimin apo refuzimin e aplikimit për akreditim	23 days	Wed 25/12/24	Thu 16/01/25
33	★	Periudha e ankesave në PZAP ndaj vendimit të KQZ	25 days	Wed 25/12/24	Sat 18/01/25
34	★	Tërheqja e distinktivëve për vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike	11 days	Sat 25/01/25	Tue 04/02/25
35	→	<b>Aplikimi për akreditim të vëzhguesve të organizatave jo qeveritare, qeveritare, ndërqeveritare, organizata ndërkombëtare, përfaqësues të vendeve të huaja</b>	<b>25 days</b>	<b>Sat 11/01/25</b>	<b>Tue 04/02/25</b>
36	★	Aplikimi për akreditim	15 days	Sat 11/01/25	Sat 25/01/25
37	★	KQZ merr vendim për aprovimin apo refuzimin e aplikimit për akreditim	14 days	Mon 13/01/25	Sun 26/01/25
38	★	Periudha e ankesave në PZAP ndaj vendimit të KQZ	18 days	Mon 13/01/25	Thu 30/01/25
39	★	Tërheqja e distinktivëve për vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike	5 days	Fri 31/01/25	Tue 04/02/25
40	→	<b>Aplikimi për akreditim të vëzhguesve të mediave vendore dhe ndërkombëtare</b>	<b>20 days</b>	<b>Tue 21/01/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
41	★	Aplikimi për akreditim	15 days	Tue 21/01/25	Tue 04/02/25
42	★	KQZ merr vendim për aprovimin apo refuzimin e aplikimit për akreditim	15 days	Wed 22/01/25	Wed 05/02/25
43	★	Periudha e ankesave në PZAP ndaj vendimit të KQZ	16 days	Thu 23/01/25	Fri 07/02/25
44	★	Tërheqja e distinktivëve për vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike	3 days	Fri 07/02/25	Sun 09/02/25
45	→	<b>Programi njoftues për vëzhguesit ndërkombëtar</b>	<b>3 days</b>	<b>Sat 08/02/25</b>	<b>Mon 10/02/25</b>
46	★	Organizimi i vëzhgimit të procesit zgjedhor për vëzhguesit ndërkombëtar në Qenda të Votimit, Qendra Komunale të Numërimit, Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3 days	Sat 08/02/25	Mon 10/02/25
47	→	<b>KRIJIMI I LISTËS SË VOTUESVE</b>	<b>165 days</b>	<b>Sat 17/08/24</b>	<b>Tue 28/01/25</b>
48	→	<b>Aktivite të veçanta të Shërbimit Votues për krijimi e Listës së Votuesve</b>	<b>134 days</b>	<b>Sat 17/08/24</b>	<b>Sat 28/12/24</b>
49	★	Kërkesa në MPB, ARC për pasije me Ekstratin e Parë të Regjistrimit Qendror Civil	1 day	Sat 17/08/24	Sat 17/08/24
50	★	Pranimi i Ekstraktit të parë të Regjistrimit Qendror Civil nga ARC	2 days	Mon 19/08/24	Tue 20/08/24



ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
51	✦	Kërkesa për Këshillin Gjyqësor të Kosovës për listën e personave që iu është marrë zotësia e veprimit	1 day	Mon 19/08/24	Mon 19/08/24
52	✦	Pranimi i listave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës	7 days	Sat 17/08/24	Fri 23/08/24
53	✦	Caktimi automatik dhe manual i votuesve në Qendra të Votimit	7 days	Tue 20/08/24	Mon 26/08/24
54	✦	KQZ miraton raportin e Listës Preliminare të Votuesve	1 day	Wed 28/08/24	Wed 28/08/24
55	✦	Publikimi dhe shpërndarja e Listës Preliminare të Votuesve në ueb faqen e KQZ dhe në KKZ	1 day	Thu 29/08/24	Thu 29/08/24
56	✦	Dërgimi i formularëve dhe materialeve tek KKZ-ja, lidhur me zbatimin e Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit të LV-së	2 days	Mon 26/08/24	Tue 27/08/24
57	✦	Zbatimi i Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit të LV-së	122 days	Thu 29/08/24	Sat 28/12/24
58	✦	Zbatimi i periudhës së Shërbimit Votues të KQZ për ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës	120 days	Thu 29/08/24	Thu 26/12/24
59	✦	Kërkesa dhe Pranimi i Ekstraktit të dytë të Rregjistrimit Qendror Civil nga ARC-ja	3 days	Mon 25/11/24	Wed 27/11/24
60	✦	Aplikimi i të dhënave të ekstraktit të dytë në Listën preliminare të votuesve	7 days	Wed 27/11/24	Tue 03/12/24
61	✦	Ofrimi i qasjes në Listën preliminare të votuesve për subjektet e certifikuar politike	115 days	Thu 05/09/24	Sat 28/12/24
62	✦	<b>Përgatitja e Listës Përfundimtare të Votuesve</b>	<b>36 days</b>	<b>Tue 24/12/24</b>	<b>Tue 28/01/25</b>
63	✦	Pranimi i ekstraktit të tretë të Rregjistrimit Qendror Civil nga ARC	1 day	Tue 24/12/24	Tue 24/12/24
64	✦	Aplikimi i të dhënave të ekstraktit të tretë	5 days	Tue 24/12/24	Sat 28/12/24
65	✦	Ndarja e votuesve në vendvotime	3 days	Thu 26/12/24	Sat 28/12/24
66	✦	Krijimi dhe Kontrolli i cilësisë së skedarëve PDF të LPV-ve dhe LKV-ve	2 days	Fri 03/01/25	Sat 04/01/25
67	✦	Certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve brenda dhe jashtë Kosovës	1 day	Sat 04/01/25	Sat 04/01/25
68	✦	Shtypja, kontrollimi, paketimi dhe dërgimi i Listave Votuese	20 days	Thu 09/01/25	Tue 28/01/25
69	✦	<b>QENDRAT E VOTIMIT BRENDA DHE JASHTË KOSOVËS</b>	<b>39 days</b>	<b>Sat 17/08/24</b>	<b>Tue 24/09/24</b>
70	✦	<b>Qendrat e Votimit dhe Vendvotimet brenda Kosovës</b>	<b>37 days</b>	<b>Mon 19/08/24</b>	<b>Tue 24/09/24</b>
71	✦	Inspektimin dhe vlerësimin e QV brenda Kosovës	25 days	Mon 19/08/24	Thu 12/09/24
72	✦	Identifikimi i Qendrave alternative të Votimit	25 days	Mon 19/08/24	Thu 12/09/24
73	✦	Miratimi i Qendrave alternative të Votimit nga KQZ	4 days	Fri 20/09/24	Mon 23/09/24
74	✦	Publikimi i Qendrave të Votimit (QV) brenda Kosovës sipas komunave	1 day	Tue 24/09/24	Tue 24/09/24
75	✦	<b>Krijimi i listës së përfaqësive diplomatike, caktimi i numrit të vendvotimeve dhe numrit të votuesve</b>	<b>12 days</b>	<b>Sat 17/08/24</b>	<b>Wed 28/08/24</b>
76	✦	KQZ kërkon nga MPJ listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve	11 days	Sat 17/08/24	Tue 27/08/24
77	✦	KQZ në bashkëpunim me MPJ vlerëson hapësirat fizike të përfaqësive diplomatike	11 days	Sat 17/08/24	Tue 27/08/24

ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
78	★	KQZ cakton përfaqësitë diplomatike në të cilat do të votohet, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë	7 days	Wed 21/08/24	Tue 27/08/24
79	★	KQZ publikon listën e Qendrave të Votimit për secilën përfaqësi diplomatike dhe numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë	2 days	Tue 27/08/24	Wed 28/08/24
80	➔	<b>PERIUDHA PËR REGJISTRIMIN E VOTUESVE JASHTË KOSOVËS</b>	<b>145 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Sat 11/01/25</b>
81	➔	<b>Përgatitjet për kundërshtimin administrativ</b>	<b>2 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Wed 21/08/24</b>
82	★	Hapja e një e-mail adrese të veçantë të Komisionit të themeluar nga KQZ për pranim të kundërshtimeve administrative dhe publikimi i saj	1 day	Tue 20/08/24	Tue 20/08/24
83	★	KQZ themelon Komisionin për Kundërshtim Administrativ për shqyrtimin e ankesave për refuzimin e regjistrimit si votues jashtë Kosovës	1 day	Wed 21/08/24	Wed 21/08/24
84	➔	<b>Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës</b>	<b>142 days</b>	<b>Fri 23/08/24</b>	<b>Sat 11/01/25</b>
85	★	Dizajnimi i formularëve të aplikimit për regjistrim	6 days	Fri 23/08/24	Wed 28/08/24
86	★	Përditësimi i informatave në platformën elektronike	6 days	Fri 23/08/24	Wed 28/08/24
87	★	Periodha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës	120 days	Thu 29/08/24	Thu 26/12/24
88	★	Njoftimi i aplikuesve për pranimin ose refuzimin e aplikimit	122 days	Thu 29/08/24	Sat 28/12/24
89	★	Afati për paraqitjen e kundërshtimit administrativ për refuzim të regjistrimit si votues jashtë Kosovës në Komisionin e themeluar nga KQZ	121 days	Thu 29/08/24	Fri 27/12/24
90	★	Afati i ankesës në PZAP pas vendimit të KQZ për refuzimin e aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës	122 days	Fri 30/08/24	Sun 29/12/24
91	★	Përditësimi i bazës së të dhënave të Listës së Votuesve jashtë Kosovës pas vendimeve të PZAP-it	5 days	Tue 07/01/25	Sat 11/01/25
92	★	Përditësimi i listës së votuesve jashtë Kosovës në platformë	121 days	Thu 29/08/24	Fri 27/12/24
93	➔	<b>PERIUDHA PËR VOTIMIN JASHTË KOSOVËS PËR QYTETARËT E REGJISTRUAR SUKSESSHËM</b>	<b>168 days</b>	<b>Tue 27/08/24</b>	<b>Mon 10/02/25</b>
94	➔	<b>Votimi jashtë Kosovës sipas votuesve të regjistruar</b>	<b>166 days</b>	<b>Tue 27/08/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
95	★	Hapja e kutisë postare brenda vendit	1 day	Tue 27/08/24	Tue 27/08/24
96	★	Hapja e kutive postare jashtë vendit	97 days	Fri 20/09/24	Wed 25/12/24
97	★	Shpërndarja e materialit zgjedhor sensitiv në Përfaqësi Diplomate	5 days	Sat 01/02/25	Wed 05/02/25
98	★	Votimi në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës për votuesit e regjistruar	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
99	★	Afati për dërgimin e fletëvotimeve përmes postës në kutinë postare të shtetit ku është regjistruar votuesi apo në shtetin më të afërt ku është hapur kutia postare	31 days	Thu 09/01/25	Sat 08/02/25
100	★	Afati për dërgimin e fletëvotimeve përmes postës në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë	31 days	Thu 09/01/25	Sat 08/02/25
101	➔	<b>Aktivitetet pas përfundimit të votimit jashtë Kosovës</b>	<b>32 days</b>	<b>Fri 10/01/25</b>	<b>Mon 10/02/25</b>



ID	Tasli Mori	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
102	✈	Grumbullimi i materialeve zgjedhore në përfaqësi diplomatike dhe blombimi i tyre	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
103	✈	Marrja e dërgesave postare në kutitë postare jashtë Kosovës dhe dërgimi i tyre në KQZ, Kosovë	32 days	Fri 10/01/25	Mon 10/02/25
104	✈	Marrja e dërgesave postare nga kutia postare brenda Kosovës dhe dërgimi i tyre në QNR, Kosovë	32 days	Fri 10/01/25	Mon 10/02/25
105	👉	<b>PERIUDHA PËR REGJISTRIMIN E VOTUESVE ME NEVOJA TË VEÇANTA QË NUK MUND TË VOTOJNË NË VENDVOTIM</b>	<b>36 days</b>	<b>Sat 04/01/25</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
106	👉	<b>Regjistrimi për Votim i Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV)</b>	<b>36 days</b>	<b>Sat 04/01/25</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
107	✈	Regjistrimi i votuesve me nevoja të veçanta dhe votuesve në institucione përmes platformës elektronike dhe KKZ	33 days	Sat 04/01/25	Wed 05/02/25
108	✈	Dërgimi i kërkesave në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për informacione për VNV nga kjo kategori	1 day	Mon 27/01/25	Mon 27/01/25
109	✈	Regjistrimi i votuesve në institucione	7 days	Thu 30/01/25	Wed 05/02/25
110	✈	Dërgimi i kërkesave në Polici, Gjykata për informacione për votues në arrest shtëpiak	1 day	Thu 30/01/25	Thu 30/01/25
111	✈	Regjistrimi i votuesve në rrethana të veçanta	7 days	Thu 30/01/25	Wed 05/02/25
112	✈	KKZ-ja lëshon njoftim me shkrim të dhënë nga KQZ-ja për votuesit e refuzuar për regjistrim nga këto kategori	33 days	Sat 04/01/25	Wed 05/02/25
113	✈	Afati për paraqiten e ankesave në PZAP lidhur me refuzimin për regjistrim si VPNV	34 days	Sat 04/01/25	Thu 06/02/25
114	✈	Afati i fundit i PZAP për vendosje lidhur me ankesat e parashtruara	34 days	Sun 05/01/25	Fri 07/02/25
115	✈	Përditësimi i bazës së të dhënave të VPNV pas vendimeve të PZAP-it	1 day	Fri 07/02/25	Fri 07/02/25
116	✈	Konfirmimi i LV për VPNV	1 day	Fri 07/02/25	Fri 07/02/25
117	✈	Vulosja e emrave të votuesve VPNV në Listën Votuese për të pamundësuar votimin e tyre në vendvotim të rregullt	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
118	👉	<b>FORMIMI I KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE</b>	<b>24 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Thu 12/09/24</b>
119	👉	<b>Aktivitetet për formimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve</b>	<b>24 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Thu 12/09/24</b>
120	✈	KQZ u dërgon ftesë Subjekteve Politike për nominime për anëtarë të KKZ-ve sipas komunave	2 days	Tue 20/08/24	Wed 21/08/24
121	✈	Afati për Subjekte Politike për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të KKZ-ve sipas komunave	16 days	Thu 22/08/24	Fri 06/09/24
122	✈	Shqyrtimi dhe verifikimi i propozimeve të Subjekteve Politike për anëtarë të KKZ-ve	16 days	Thu 22/08/24	Fri 06/09/24
123	✈	Refuzimi i emërimit të anëtarit në KKZ nga KQZ dhe njoftimi subjektiv	16 days	Thu 22/08/24	Fri 06/09/24
124	✈	Afati për paraqiten e ankesave në PZAP lidhur me refuzimin e emërimit në KKZ nga KQZ	21 days	Thu 22/08/24	Wed 11/09/24
125	✈	KQZ emëron Anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve	2 days	Wed 11/09/24	Thu 12/09/24
126	👉	<b>FORMIMI I KËSHILLAVE TË VENDVOTIMIT</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>



ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
127		<b>Formimi i Këshillave të Vendvotimit brenda vendit</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
128		<b>Aktivitetet për formimin e Këshillave të Vendvotimit</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
129		SKQZ u dërgon ftesë Subjekteve Politike për nominime për anëtarë të KVV-ve sipas komunave	1 day	Wed 08/01/25	Wed 08/01/25
130		Afati për Subjekte Politike për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të KVV-ve sipas komunave	5 days	Thu 09/01/25	Mon 13/01/25
131		Shqyrtimi dhe verifikimi i propozimeve të Subjekteve Politike për anëtarë të KVV-ve sipas komunave	4 days	Tue 14/01/25	Fri 17/01/25
132		Verifikimi i Anëtarëve të KVV-ve	10 days	Thu 09/01/25	Sat 18/01/25
133		Refuzimi i emërimit të anëtarit në KKZ nga KQZ dhe njoftimi subjektit	8 days	Thu 09/01/25	Thu 16/01/25
134		Afati për paraqiten e ankesave në PZAP lidhur me refuzimin e emërimit në KVV	2 days	Thu 16/01/25	Fri 17/01/25
135		Afati i fundit i PZAP për vendosje lidhur me ankesat e parashtruara	3 days	Fri 17/01/25	Sun 19/01/25
136		Afati për plotësimin e vendeve të mbetura të lira për anëtarë të KVV-ve	2 days	Sun 19/01/25	Mon 20/01/25
137		KQZ emëron Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit	14 days	Thu 09/01/25	Wed 22/01/25
138		<b>Formimi i Këshillave të vendvotimit në përfaqësitë diplomatike</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
139		<b>Aktivitetet për formimin e Këshillave të Vendvotimit në përfaqësi diplomatike</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
140		SKQZ u dërgon ftesë Subjekteve Politike për nominime për anëtarë të KVV-ve sipas përfaqësive diplomatike	1 day	Wed 08/01/25	Wed 08/01/25
141		Afati për Subjekte Politike për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të KVV-ve sipas përfaqësive diplomatike	5 days	Thu 09/01/25	Mon 13/01/25
142		Shqyrtimi dhe verifikimi i propozimeve të Subjekteve Politike për anëtarë të KVV-ve sipas përfaqësive diplomatike	4 days	Tue 14/01/25	Fri 17/01/25
143		Afati për paraqitjen e përmirësimeve, korrigjimeve	11 days	Wed 08/01/25	Sat 18/01/25
144		Afati i fundit për KQZ për emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit për secilën përfaqësi diplomatike	14 days	Thu 09/01/25	Wed 22/01/25
145		<b>Formimi i ekipeve mobile për votimin e personave me nevoja të veçanta</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
146		<b>Aktivitetet për formimin e Ekipeve Mobile për VPNV</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 08/01/25</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
147		SKQZ u dërgon ftesë Subjekteve Politike për nominime për anëtarë të Këshillave të Vendvotimit, Ekipeve Mobile sipas komunave	1 day	Wed 08/01/25	Wed 08/01/25
148		Afati për Subjekte Politike për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të Këshillave të Vendvotimit, Ekipeve Mobile sipas komunave	5 days	Thu 09/01/25	Mon 13/01/25
149		Shqyrtimi dhe verifikimi i propozimeve të Subjekteve Politike për anëtarë të Këshillave të Vendvotimit, Ekipeve Mobile sipas komunave	4 days	Tue 14/01/25	Fri 17/01/25

ID	Tasli Mod	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
150	✈	Afati për paraqitjen e përmirësimeve, korigjimeve	11 days	Wed 08/01/25	Sat 18/01/25
151	✈	Afati i fundit për KQZ për emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit , Ekiyeve Mobile sipas komunave	14 days	Thu 09/01/25	Wed 22/01/25
152	✈	<b>FORMIMI I EKIPEVE TË NUMËRIMIT NË QENDRAT KOMUNALE TË NUMËRIMIT</b>	15 days	Wed 08/01/25	Wed 22/01/25
153	✈	<b>DIZAJNIMI, MIRATIMI, SHYTPJA DHE TRANSPORTI I FLETËVOTIMIT, BROSHURËS DHE LISTËS VOTUESE</b>	165 days	Mon 19/08/24	Thu 30/01/25
154	✈	<b>Dizajnimi dhe specifikat e fletëvotimeve dhe broshurave</b>	143 days	Mon 19/08/24	Wed 08/01/25
155	✈	Përgatitja e specifikave teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave dhe miratimi në KQZ	11 days	Mon 19/08/24	Thu 29/08/24
156	✈	Dizajnimi i fletëvotimit dhe broshurës dhe miratimi i dizajnit në KQZ	11 days	Mon 19/08/24	Thu 29/08/24
157	✈	Miratimi i specifikimeve teknike dhe modeleve të dizajnit për fletëvotime dhe broshura	2 days	Thu 29/08/24	Fri 30/08/24
158	✈	Miratimi i përmbajtjes dhe dizajnit final në KQZ (pas tërheqjes së shortit), dizajnimi dhe kontrolli i kualitetit	2 days	Tue 07/01/25	Wed 08/01/25
159	✈	Miratimi i numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që do të shtypen	3 days	Sun 05/01/25	Tue 07/01/25
160	✈	<b>Shtypja, paketimi, transporti dhe mbikëqyrja e procesit të fletëvotimeve dhe broshurave</b>	23 days	Wed 08/01/25	Thu 30/01/25
161	✈	Dërgimi i modelit,modeleve të fletëvotimit për shtyp tek kontraktori	1 day	Wed 08/01/25	Wed 08/01/25
162	✈	Kontrolli i kualiteti të formës finale të fletëvotimeve dhe broshurave pas PrePrint	2 days	Wed 08/01/25	Thu 09/01/25
163	✈	Shtypja dhe paketimi i fletëvotimeve dhe broshura	20 days	Thu 09/01/25	Tue 28/01/25
164	✈	Mbikëqyrja e procesit të shtypjes së fletëvotimeve dhe broshurave	20 days	Thu 09/01/25	Tue 28/01/25
165	✈	Dërgimi i fletëvotimeve në KQZ	3 days	Tue 28/01/25	Thu 30/01/25
166	✈	<b>FORMULARËT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJE</b>	53 days	Tue 03/09/24	Fri 25/10/24
167	✈	Përgatitja e draftit të formularëve të Zgjedhjeve	43 days	Tue 03/09/24	Tue 15/10/24
168	✈	Kontrolli i kualitetit të formularëve të Zgjedhjeve	5 days	Wed 16/10/24	Sun 20/10/24
169	✈	Përgatitja e draftit të procedurave të Zgjedhjeve	43 days	Tue 03/09/24	Tue 15/10/24
170	✈	Kontrolli i kualitetit të procedurave të Zgjedhjeve	5 days	Wed 16/10/24	Sun 20/10/24
171	✈	KQZ miraton formularët dhe procedurave të Zgjedhjeve	5 days	Mon 21/10/24	Fri 25/10/24
172	✈	<b>PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR STAFIN ZGJEDHOR DHE TRUPAT ZGJEDHORE</b>	167 days	Mon 26/08/24	Sat 08/02/25
173	✈	<b>Faza përgatitore</b>	10 days	Mon 26/08/24	Wed 04/09/24
174	✈	Përgatitja e specifikave për materialet e trajnimit	10 days	Mon 26/08/24	Wed 04/09/24
175	✈	<b>Faza e zbatimit të programit të trajnimit</b>	161 days	Sun 01/09/24	Sat 08/02/25
176	✈	<b>Programi trajnues për Trajnerët e SKQZ-së</b>	12 days	Mon 04/11/24	Fri 15/11/24
177	✈	Përgatitja e materialit të trajnimit	5 days	Mon 04/11/24	Fri 08/11/24



ID	Tasli Mori	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
178	★	Mbajtja e programit trajnues për Trajnerët e SKQZ-së mbi procedurat e votimit dhe numërimit	4 days	Tue 12/11/24	Fri 15/11/24
179	→	<b>Programi orientues për anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve</b>	<b>27 days</b>	<b>Sun 01/09/24</b>	<b>Fri 27/09/24</b>
180	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	14 days	Sun 01/09/24	Sat 14/09/24
181	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e KKZ-ve mbi procedurat e funksionimit, te drejtave dhe përgjegjësi gjatë mandatit të tyre në proceset zgjedhore	13 days	Sun 15/09/24	Fri 27/09/24
182	→	<b>Programi trajnues për anëtarët e Këshillave të Vendvotimit dhe ekipeve të Qendrave Komunale të Numërimit (QKN)</b>	<b>120 days</b>	<b>Sat 12/10/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
183	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	95 days	Sat 12/10/24	Tue 14/01/25
184	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e KVV-ve mbi procedurat e votimit dhe numërimit ne VV	5 days	Wed 15/01/25	Sun 19/01/25
185	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e QKN-ve mbi procedurat e numërimit	25 days	Wed 15/01/25	Sat 08/02/25
186	★	Mbajtja e trajnimit rifreskues për Kryesues të KVV-ve dhe anëtarët e QKN-ve para ditës së zgjedhjeve	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
187	→	<b>Programi trajnues për anëtarët e Ekipeve Mobile të VPNV-ve</b>	<b>7 days</b>	<b>Sat 01/02/25</b>	<b>Fri 07/02/25</b>
188	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	1 day	Sat 01/02/25	Sat 01/02/25
189	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e Ekipenve Mobile të VPNV-ve mbi procedurat e votimit dhe numërimit	5 days	Mon 03/02/25	Fri 07/02/25
190	→	<b>Programi trajnues për anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve në përfaqësi diplomatike</b>	<b>120 days</b>	<b>Sat 12/10/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
191	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	95 days	Sat 12/10/24	Tue 14/01/25
192	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e KKV në përfaqësi diplomatike mbi procedurat e votimit, numërimit dhe pranim dorëzimit	25 days	Wed 15/01/25	Sat 08/02/25
193	→	<b>Programi trajnues për anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve</b>	<b>25 days</b>	<b>Tue 14/01/25</b>	<b>Fri 07/02/25</b>
194	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	18 days	Tue 14/01/25	Fri 31/01/25
195	★	Mbajtja e programit trajnues për anëtarët e KKZ-ve për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve zgjedhore ditën e zgjedhjeve nga KVV në QKN	5 days	Mon 03/02/25	Fri 07/02/25
196	→	<b>Programi trajnues për stafin e angazhuar në QNR</b>	<b>25 days</b>	<b>Tue 14/01/25</b>	<b>Fri 07/02/25</b>
197	★	Përgatitja e programit dhe materialit të trajnimit	18 days	Tue 14/01/25	Fri 31/01/25
198	★	Mbajtja e programit trajnues për stafin në QNR për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KKZ në QNR (VV e rregullta, QKN, materialet nga votimi ne perfaqesi diplomatike, materialet nga ekipet mobile, materialet nga VV me kusht)	5 days	Mon 03/02/25	Fri 07/02/25
199	★	<b>FUSHATA E INFORMIMIT PUBLIK</b>	<b>174 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
200	★	KQZ miraton Planin për Edukim dhe Informim Publik	22 days	Tue 20/08/24	Tue 10/09/24



ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
201		Fushata informuese për periudhën e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve	128 days	Sun 01/09/24	Mon 06/01/25
202		Fushata informuese për periudhën e aplikimit për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve	42 days	Wed 25/12/24	Tue 04/02/25
203		Fushata informuese për të Drejtën për të Zgjedhë dhe për t'u Zgjedhur	88 days	Sun 15/09/24	Wed 11/12/24
204		Fushata informuese për periudhën e ndërrimit të Qendrës së Votimit dhe Kundërshtimit dhe Konfirmimit të LV	120 days	Thu 29/08/24	Thu 26/12/24
205		Fushata informuese për periudhën e regjistrimit për Votim të Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV)	36 days	Sat 04/01/25	Sat 08/02/25
206		Fushata informuese për Vendvotimet e Caktuara për Votim me Kusht	52 days	Fri 20/12/24	Sun 09/02/25
207		Fushata informuese për plotësimin e fletëvotimit	68 days	Wed 04/12/24	Sun 09/02/25
208		Fushata informuese për periudhën e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës	166 days	Tue 27/08/24	Sat 08/02/25
209		Fushata informuese për periudhën e votimit të votuesve të regjistruar jashtë Kosovës	166 days	Tue 27/08/24	Sat 08/02/25
210		Fushatë informuese për Parandalimin e Keqpërdorimit të Votës	47 days	Wed 25/12/24	Sun 09/02/25
211		Fushatë Motivuese	35 days	Sun 15/12/24	Sat 18/01/25
212		Fushata informuese për transparencë të numërimit të votave në QKN dhe QNR	33 days	Wed 08/01/25	Sun 09/02/25
213		<b>AKTIVITETE TË NDRYSHME NË TERREN</b>	<b>137 days</b>	<b>Wed 25/09/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
214		<b>Plani Operacional i Sigurisë</b>	<b>136 days</b>	<b>Wed 25/09/24</b>	<b>Fri 07/02/25</b>
215		Hartimi i Planit Operacional të Sigurisë	17 days	Wed 25/09/24	Fri 11/10/24
216		Miratimi i Planit Operacional të Sigurisë nga KQZ	3 days	Sat 12/10/24	Mon 14/10/24
217		Mbajtja e programit orientues për Menaxheret e Qendrave të Votimit nga KKZ-të	5 days	Mon 03/02/25	Fri 07/02/25
218		<b>Shpërndarja e materialit zgjedhor në komuna</b>	<b>6 days</b>	<b>Mon 03/02/25</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
219		Shpërndarja e materialit zgjedhor jo-sensitiv nga depo qendrore e KQZ-së në QKN	3 days	Mon 03/02/25	Wed 05/02/25
220		Shpërndarja e materialit zgjedhor jo-sensitiv nga QKN në Qendra të Votimit	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
221		Shpërndarja e materialit zgjedhor sensitiv nga depo qendrore e KQZ-së në QKN	2 days	Thu 06/02/25	Fri 07/02/25
222		<b>Përgatitja teknike e Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve</b>	<b>1 day</b>	<b>Sat 08/02/25</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
223		Rregullimi i Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve para Ditës së Zgjedhjeve	1 day	Sat 08/02/25	Sat 08/02/25
224		<b>FORMIMI I QENDRAVE KOMUNALE TË NUMËRIMIT (QKN) DHE AKTIVITETET QË ZHVILLOHEN</b>	<b>163 days</b>	<b>Wed 21/08/24</b>	<b>Thu 30/01/25</b>
225		<b>Lista e Qendrave Komunale të Numërimit</b>	<b>10 days</b>	<b>Wed 21/08/24</b>	<b>Fri 30/08/24</b>
226		Evidentimi dhe vlerësimi i hapësirave për formimin e Qendrave Komunale të Numërimit	5 days	Wed 21/08/24	Sun 25/08/24
227		KQZ njofton komunitat për lokacionet e rekomanduara për QKN	5 days	Wed 21/08/24	Sun 25/08/24

ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
228	★	KQZ nënshkruan memorandum bashkëpunimi me komunën përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave dhe kushtet teknike	6 days	Sat 24/08/24	Thu 29/08/24
229	★	Miratimi i listës së Qendrave Komunale të Numërimit dhe publikimi i adresës së tyre	1 day	Fri 30/08/24	Fri 30/08/24
230	→	<b>Përgatitja e Qendrave Komunale të Numërimit</b>	<b>1 day</b>	<b>Thu 30/01/25</b>	<b>Thu 30/01/25</b>
231	★	Rregullimi i hapësirës së Qendrave Komunale të Numërimit	1 day	Thu 30/01/25	Thu 30/01/25
232	★	KKZ organizon vizitë në QKN për subjektet politike, vëzhguesit dhe anëtarët e KKZ-së	1 day	Thu 30/01/25	Thu 30/01/25
233	→	<b>QENDRA E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE</b>	<b>173 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
234	→	<b>Lokacioni i QNR</b>	<b>173 days</b>	<b>Tue 20/08/24</b>	<b>Sat 08/02/25</b>
235	★	Funksionalizimi i QNR-së	15 days	Tue 20/08/24	Tue 03/09/24
236	★	Përgatitja e objektit, definimi dhe dizajnimi i hapësirave në QNR	159 days	Tue 03/09/24	Sat 08/02/25
237	→	<b>AKTIVITETET PËRGATITORE PËR REZULTATET PRELIMINARE</b>	<b>129 days</b>	<b>Mon 16/09/24</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
238	→	<b>Aktivitetet përgatitore për publikimin e rezultateve preliminare</b>	<b>129 days</b>	<b>Mon 16/09/24</b>	<b>Wed 22/01/25</b>
239	★	Testimi i ueb aplikacionit dhe konfigurimi i tabletave	85 days	Mon 16/09/24	Mon 09/12/24
240	★	Mbajtja e programit trajnues për operatorët	7 days	Mon 09/12/24	Sun 15/12/24
241	★	Testimi i parë nga tereni përmes operatorëve	2 days	Tue 17/12/24	Wed 18/12/24
242	★	Testimi i dytë nga tereni përmes operatorëve	2 days	Tue 21/01/25	Wed 22/01/25
243	★	<b>DITA E ZGJEDHJEVE</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
244	→	<b>Shpërndarja e materialit zgjedhor</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
245	★	Shpërndarja e materialit zgjedhor sensitiv nga QKN-të në Qendra të Votimit	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
246	→	<b>Fillimi i votimit</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
247	★	Hapja e Vendvotimeve	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
248	★	Raportimi i Kryesuesve të Vendvotimeve për hapjen e Vendvotimeve	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
249	→	<b>Numërimi i fletëvotimeve</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
250	★	Numërimi i fletëvotimeve për Subjektet Politike	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
251	→	<b>Rezultatet Preliminare</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
252	★	Publikimi i daljes në zgjedhje dhe Rezultateve Preliminare të Subjekteve Politike dhe statistikave tjera në Ditën e Zgjedhjeve	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
253	→	<b>Dërgimi i materialit zgjedhor nga QV në Qendra Komunale të Numërimit</b>	<b>1 day</b>	<b>Sun 09/02/25</b>	<b>Sun 09/02/25</b>
254	★	Pranimi i materialeve të vendvotimeve të rregullta, me kusht dhe VPNV	1 day	Sun 09/02/25	Sun 09/02/25
255	→	<b>AFATET DHE PLANI I AKTIVITETEVE PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE DERI NË CERTIFIKIM TË REZULTATEVE</b>	<b>102 days</b>	<b>Mon 10/02/25</b>	<b>Thu 22/05/25</b>
256	→	<b>MONITORIMI DHE DEKLARIMI FINANCIAR I FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE</b>	<b>60 days</b>	<b>Mon 10/02/25</b>	<b>Thu 10/04/25</b>



ID	Tasli Moc	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
257	★	Zyra kërkon nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) të dhënat e monitorimit të fushatës së zgjedhjeve	11 days	Mon 10/02/25	Thu 20/02/25
258	★	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) i dërgon në Zyrë, të dhënat e monitorimit të fushatës së zgjedhjeve	16 days	Mon 10/02/25	Tue 25/02/25
259	★	Dorëzimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve	60 days	Mon 10/02/25	Thu 10/04/25
260	★	<b>ASGJËSIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR</b>	60 days	Tue 18/03/25	Fri 16/05/25
261	➔	<b>AKTIVITETET E VOTIMIT JASHTË KOSOVËS</b>	<b>11 days</b>	<b>Mon 10/02/25</b>	<b>Thu 20/02/25</b>
262	★	Përgatitja dhe dërgimi i materialeve zgjedhore të grumbulluara në përfaqësitë diplomatike dhe dërgimi i tyre si postë diplomatike	1 day	Mon 10/02/25	Mon 10/02/25
263	★	Skanimi i listës së votuesve të vendotimeve në përfaqësitë diplomatike	2 days	Wed 12/02/25	Thu 13/02/25
264	★	Vlerësimi i pakove me fletëvotime	8 days	Thu 13/02/25	Thu 20/02/25
265	➔	<b>PROCESI I NUMËRIMIT TË FLETËVOTIMEVE PËR KANDIDATË NË QKN</b>	<b>10 days</b>	<b>Mon 10/02/25</b>	<b>Wed 19/02/25</b>
266	★	Numërimi i fletëvotimeve për kandidatët	10 days	Mon 10/02/25	Wed 19/02/25
267	★	<b>DËRGIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NGA QKN NË QENDRËN E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE (QNR)</b>	11 days	Wed 12/02/25	Sat 22/02/25
268	➔	<b>AKTIVITETET NË QNR PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE</b>	<b>101 days</b>	<b>Tue 11/02/25</b>	<b>Thu 22/05/25</b>
269	➔	<b>Pranimi i materialit zgjedhor nga QKN-të në QNR</b>	<b>13 days</b>	<b>Wed 12/02/25</b>	<b>Mon 24/02/25</b>
270	★	Pranimi, Kontrollimi dhe shperndarja e materialit nepër hapësira	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
271	★	Hetimi i materialeve nga Karantina	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
272	★	Evidentimi dhe arkivimi i kutive të votimit (në hapësirën e kutive të votimit)	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
273	★	Dergo format (VV e rregullta), LV, Libri i votimit në hapësirën e FDh.	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
274	★	Skanimi i Formularëve të Rezultateve dhe publikimi në ëebfaqe të KQZ-së	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
275	➔	<b>Procesi i hetimit</b>	<b>13 days</b>	<b>Wed 12/02/25</b>	<b>Mon 24/02/25</b>
276	★	Shkruaj propozime dhe rekomandime për vendime të KQZ-së	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
277	➔	<b>Aktivitetet e futjes se të dhënave</b>	<b>101 days</b>	<b>Tue 11/02/25</b>	<b>Thu 22/05/25</b>
278	➔	<b>LPV E FDh</b>	<b>13 days</b>	<b>Wed 12/02/25</b>	<b>Mon 24/02/25</b>
279	★	Skanimi i dyfishtë i LPV + rishikimi i mbikqyrësit (60 nënpunës të FDh, 2500 LPV)	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
280	➔	<b>FDh - Auditimi dhe Hetimi</b>	<b>13 days</b>	<b>Wed 12/02/25</b>	<b>Mon 24/02/25</b>
281	★	Auditimi dhe hetimi (10 + 10 për ndërrim), (në proces)	13 days	Wed 12/02/25	Mon 24/02/25
282	➔	<b>Votat me kusht (përfshirë VPNV)</b>	<b>15 days</b>	<b>Wed 12/02/25</b>	<b>Wed 26/02/25</b>
283	★	Kontrollo numrin total të ZFK per VV te dyfishtë	15 days	Wed 12/02/25	Wed 26/02/25
284	★	Verifikimi I ZFK&VPNV	15 days	Wed 12/02/25	Wed 26/02/25



ID	Tasli Mori	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Fillimi	Përfundimi
285		Regjistrimi i votave me kusht dhe VPNV në bazën e të dhënave	15 days	Wed 12/02/25	Wed 26/02/25
286		Numërimi i Votave me kusht dhe VPNV	15 days	Wed 12/02/25	Wed 26/02/25
287		<b>Votimi Jashtë Kosovës , me Postë</b>	<b>91 days</b>	<b>Fri 21/02/25</b>	<b>Thu 22/05/25</b>
288		Krijimi i dengjeve,numërimi	91 days	Fri 21/02/25	Thu 22/05/25
289		Numërimi i votave me postë	3 days	Sun 23/02/25	Tue 25/02/25
290		FDh e FRD	3 days	Wed 26/02/25	Fri 28/02/25
291		<b>Publikimi i rezultateteve [nëse nuk ka rinumërim dhe ankesa]</b>	<b>36 days</b>	<b>Tue 11/02/25</b>	<b>Tue 18/03/25</b>
292		KQZ shpallë Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Subjektet Politike dhe Kandidatët	1 day	Wed 05/03/25	Wed 05/03/25
293		Ankesat në PZAP	1 day	Tue 11/02/25	Tue 11/02/25
294		Ankesat në Gjykatë Supreme	6 days	Tue 11/03/25	Sun 16/03/25
295		Zbatimi i vendimeve të PZAP-t dhe Gjykatës Supreme	2 days	Mon 17/03/25	Tue 18/03/25
296		KQZ certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Subjektet Politike dhe Kandidatët	1 day	Tue 18/03/25	Tue 18/03/25



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me 98 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 21.08.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kundërshtimit administrativ të parashtruar kundër njoftimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës

- I. Themelohet Komisioni për shqyrtimin e kundërshtimit administrativ të parashtruar kundër njoftimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, në këtë përbërje:
  1. Emira Alushi Murati- Kryesues
  2. Lirik Krasniqi – Anëtar
  3. Premtim Rustemi - Anëtar
- II. Komisioni do të ketë mandat për shqyrtimin e kundërshtimeve administrative të parashtruara kundër njoftimit për regjistrim të votueseve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- III. Obligohet Komisioni të njoftoj KQZ.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 21.08.2024, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I.** **Znj.Edona Luzha**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Rabije Sallahi.
- II.** Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Edona Luzha dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 15.08.2024, Nr.09/1-1181/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Rabije Sallahi, e cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të punësimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Edona Luzha.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

**Prishtinë 21.08.2024**

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

**Kreshnik Radonija**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me neni 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 23 të Rregullores së Brendshme Nr. 02/2024, Për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 21.08.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për miratimin e grupit të parë të pozitive sipas departamenteve, për angazhimin e stafit jo permanent për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- I. Miratohet grupit të parë i pozitive sipas departamenteve, për angazhimin e stafit jo permanent për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Lista si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Grupi i pare i angazhimit te personelit te perkohshem

Nr.	Emri i pozitë	Nr. i të angazhu arve	Data e njoftimit për aplikim	Afati për aplikim	Periudha e angazhimit
1	Zyrtar për Teknologji Informative në KQZ	1			
2	Zyrtar i Shërbimit për Votues	1			
3	Zyrtar për Dizajn	1			
4	Zyrtar i Personelit	1			
5	Zyrtar për certifikim të subjekteve politike	5			
6	Zyrtar per Operacione Zgjedhore	1			
7	Staf teknik dhe mirembajtje	3			
8	Asistent administrativ	2			
9	Fotograf	1			
10	Perkthyes	3			
11	ZEKKZ	6			
12	Keshilltar Juridik ne ZRCKFSP	1			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59, 63 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 21 të Rregullores së Punës së KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 21.08.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar për Pjesëmarrje në Simpoziumin “Dezinformim, Koordinim: Mësime nga Zgjedhjet e Evropës 2024 në Operacionet Kundër Ndikimit”

- I. Miratohet udhëtimi zyrtar, për pjesëmarrjen e KQZ në simpoziumin “, Dezinformim, Koordinim: Mësime nga Zgjedhjet e Evropës 2024 në Operacionet Kundër Ndikimit”.
- II. Udhëtimi do të realizohet në Pragë, Republika Çeke, më 12, 13 dhe 14 shtator 2024.
- III. Pjesëmarrës në këtë udhëtim janë:
  1. Alban Krasniqi
- IV. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

